

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI

"TE TIKU " SH.P.K

Kreu 1

Neni 1 Krijimi

Sot, më 16/06/2023, themeluesi, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin

" **TE TIKU** " shpk.


Themeluesi i shoqërisë është :

Adriatik Llangozi lindur ne Tirane date 05.03.1970 dhe banues ne Tirane, Njesia 4, Rruga Aleksander Mojsiu Nd 137 H 7 AP9 identifikuar me ID Nr 035028250 dhe Nr personal H00305178W

Ligji është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" ose ligji "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",

Shoqeria "TE TIKU " shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Ortaku i vetem harton kete Statut si me poshte:



Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqeria "Te Tiku " shpk, eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga ortake, te cilet nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Ortaku gezon kuoten e tij ne shoqeri, ne perpjesetim me kontributin qe ka dhene ne kapital.

Neni 3 Selia

Selia e shoqerise: Njesia Bashkiake Nr 2, Rruga Gjeneral Nikolas, Ndertesa 1 Kateshe objekti Nr 12

Adresa Elektronike: adriatikllangozi@gmail.com

Selia e aktivitetit te shoqerise: -----

Adresa e faqes se internetit te shoqerise eshte (nese ka): -----

Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon (nese ka): -----


Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4 Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te ushtroje aktivitet privat ne fushen e:

Bar – Kafe, Restorant, Sherbime Catering, Delivery, Organizime Eventesh., Struktura Akomoduase, Organizimi i Guidave Turistike.

Ajo mundet gjithashtu, nen rezerven e kufizimeve ligjore, te beje te gjitha operacionet tregtare, industriale, te luajtshme, te paluajtshme apo financiare qe lidhen direkt ose indirekt me objektin e saj shoqeror.



Neni 5 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pa percaktuar .

KREU II

KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 LEKE.

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht nga "ortaku"i shoqerise:

- **Adriatik Llangozi** zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme **100.000** (njqindmije) Leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.


Kontributet e ortakeve mund te jene ne para ose ne natyre (makineri, pajisje, pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kerkeses me vendimin e asamblese se ortakeve.

Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te Asamblese se Ortakeve ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.



Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim nga administratori, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Neni 8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te shoqerise e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashegimise
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.


KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9 Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.



Asambleja e Pergjithshme Ortakeve vendos per çeshtje si:

-Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise (kuorum 50+1 te kuotave);

- Emerimin dhe shkarkimin e administrator-it—eve (kuorum 60+1 te kuotave);

c) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar (kuorum 60+1 te kuotave);

ç) Percaktimin e shperblimeve (kuorum 50+1 te kuotave)

d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administrator-i-et, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; (kuorum 50+1 te kuotave)

- perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; (me perfaqesues te zgjedhur me kuorum 50+1 te kuotave)

- miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese (kuorum 50+1 te pranishme);

Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:


- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise (kuorum 60+1 te kuotave);

- shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve (kuorum 50+1 te kuotave);

- investime (unanim);

ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise (unanim);

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.



Neni 10 Administrimi

Administrator i shoqerise eshte z. Adriatik Llangozi.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni II Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve;

- Perfaqesoje shoqerine tregtare;

c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;


ç) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;

d) krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

dh) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;

- raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtaren'

Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve edhe ne rastet kur :



- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te tij, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Neni 12 Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arrijten e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;
- ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administrator-i-et, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare


4. Ne menyre te vecante por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi pagueese per te shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Neni 13 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14 Bilanci i shoqerise dhe dividendet



Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakut te vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortak-ut-ve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 16

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, ndahen ne perpjestim me kuotat qe kane ortakët.


Neni 17 Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e tij;
- me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave te falimentimit;

ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";



d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emeratesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Asambleja e pergjithshme e Ortakeve.

Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emerom me shume se nje likuidues, perveçse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojnë veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posaçme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit.


Likuiduesi i nenshtrohet mbikeqyrjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe administratorit.

Neni 19 Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.

10



3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditoret, sipas nenit 194 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergatit,nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit gjithashtu pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet miratohen nga asambleja e pergjithshme e ortakeve.

Neni 20 Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon ç' regjistrimin e shoqerise. Ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".


Neni 21 Bashkimi

Shoqeria mund te bashkohet me nje ose me shume shoqeri nepermjet:

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njeres ose me shume prej shoqerive, qe quhen shoqerite e perthithura, te nje shoqeri tjeter ekzistuese e quajtur shoqeria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te kesaj shoqerie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese, qe bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotave te shoqerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim te nje shoqerie te re.

Neni 22 Ndarja

1. Shoqeria mund te ndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet vleresohet e prishur.



2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008"

3. Shoqerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet, quhen shoqeri pritesese dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje: kalimin te shoqerite pritesese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta;

Berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritesese, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes;

vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e tij nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, sipas seksionit V, .te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" pa kryerjen e likujdimit.

Neni 23 Shnderrimi

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrimit te saj ne shoqeri aksionare.


Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

Neni 24 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 25 Mosmarreveshjet



Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 26 Dispozita perfundimtare

Ky Statut u redaktua nga "Ortaku i Vetem i kesaj shoqerie" ne 2 ekzemplare me vlere te njejte juridike ne gjuhen shqipe.

ORTAKU I VETEM

Adriatik LLANGOZI

ADRIATIK LLANGOZI
Adriatik

Adriatik